



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 2 Prot.

Tiranë, më 21/05/2024

V E N D I M

Nr. 2, datë 21/05/2024

PËR

**HAPJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR ANËTARË DHE SEKRETARË TË
KOMISIONEVE TË ZGJEDHJEVE NË FAKULTETE/INSTITUT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6 dhe 7, si dhe vendimin nr. 1, datë 20/05/2024 të KIZ” Për konstituimin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe zgjedhjen e kryetarit të tij”, në mbledhjen e datës 21.05.2024 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Të shpallë hapjen e procesit të kandidimit për anëtarë dhe sekretarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) dhe Institut.
- 1.1 Kandidatët për anëtarë dhe sekretarë të KZF – ve dhe Institutit vetëkandidohen pranë sekretarisë së KIZ.
- 1.2 Kandidatët përfaqësues të studentëve, duhet të paraqesin vërtetimin që ndjekin studimet në fakultetin përkatës në Universitetin Politeknik të Tiranës.
- 1.3 Numri i vendeve vakante për çdo njësi kryesore është si më poshtë:
 - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 7 anëtarë dhe 1 sekretar;
 - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës 5 anëtarë dhe 1 sekretar;
 - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 5 anëtarë dhe 1 sekretar;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 5 anëtarë dhe 1 sekretar;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 5 anëtarë dhe 1 sekretar;
 - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave 5 anëtarë dhe 1 sekretar;
 - Fakulteti i Inxh. Matematike dhe Inxh. Fizike 5 anëtarë dhe 1 sekretar;

- Instituti i Gjeoshkencave

5 anëtarë dhe 1 sekretar.

- 1.4 Njëri prej anëtarëve të Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultet është përfaqësues i studentëve me përjashtim të IGEO.
- 1.5 Afati i vetëkandidimit të kandidatëve për anëtarë të KZF – ve dhe Institutit, fillon ditën e martë datë 21.05.2024 dhe përfundon ditën e enjte, datë 23.05.2024, ora 16:00.
- 1.6 Kandidimi për anëtarë dhe sekretarë të KZF-ve, kryhet pranë Sekretarisë së KIZ (Zyra e Sektorit Juridik në Rektorat nr. 116).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA

Kryetar

Alfred PJETRI

Anëtar

Albina BASHOLLI

Anëtar

Anjeza DULAJ (GJINI)

Anëtar

Nelda KOTE

Anëtar

Irida GJOKA (MARKJA)

Anëtar

Klajdi QOSHI

Anëtar

Pietro BELBA

Anëtar

Lidia HYSA

Anëtar

Konc: D. Qafa